



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Tiranë, më 16.12.2007

Njoftim per shtyp.

Autoriteti i Konkurrencës përfundon raportin “Mbi Hetimin e Thelluar në Tregun e Karburanteve” dhe fton ndërmarrjet në seancë dëgjimore

Autoriteti i Konkurrencës ka përfunduar raportin e ndërmjetëm “Mbi Hetimin e Thelluar në Tregun e Karburanteve”.

Raporti konkludon se vihen re kufizime të konkurrencës në treg si pasojë e sjelljes së koordinuar mes ndërmarrjeve kryesore që kanë fuqi të ndjeshme në tregun e shumicës dhe ndërmarrjeve të integruara vertikalisht në tregun e shitjes me pakicë.

Në mbështetje të nenit 39 të ligjit nr.9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Kodit të Procedurave Administrative, Autoriteti i Konkurrencës ka ftuar ndërmarrjet nën hetim të tërheqin një kopje të raportit dhe të paraqesin pretendimet e tyre në seancën dëgjimore të datës 26.12.2008.

Pas përfundimit të seancave dëgjimore me ndërmarrjet nën hetim, Komisioni i Konkurrencës do të vendosë me objektivitet nëse ka patur apo jo shkelje të Ligjit nr. 9121, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” duke marrë vendimet përkatëse.

Autoriteti i Konkurrencës

Rruga Sami Frashëri, nr 4, kati IV

Tiranë, Albania

Tel 04 2234504, fax 04 2234497

www.caa.gov.al

competition@caa.gov.al